



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 2528/4prot.

Datë 13.12.2022

**V E N D I M**  
**Nr. 1242/2022**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Tërnova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13.12.2022 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:** Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA në procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-46041-10-14-2022, me objekt “Blerje Vaj” me fond limit 1 497 800 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë Pa Tvsh zhvilluar në datën 27.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

**Ankimues:** “ELBA-OIL 2015” SHA  
Xibrakë Labinot fushë, Kantjeri midis fshatrave Mirakë-Xibrakë, Zona Kadastrale nr 3864, pasuria, Elbasan

**Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit  
Rruga “Liman Kaba”, Parku Olimpik, Tiranë

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e

*Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.*

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 tre anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

#### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 17.10.2022, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-46041-10-14-2022, me objekt “Blerje Vaj” me fond limit 1 497 800 (një milion e katërqind e nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë Pa Tvsh zhvilluar në datën 27.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

II.2. Në datën 27.10.2022 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 09.11.2022, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “ELBA-OIL 2015” SHA	918.600 lekë, skualifikuar
2. “Eximoil”SHA	989.500 lekë, kualifikuar
3. “B&A-02” SHA	1.146.830 lekë, skualifikuar
4. “Top Oil”SHA	1.467.600 lekë kualifikuar
5. Alfred Kopaçi”	1.796.400 lekë skualifikuar

Në datën 09.11.2022 operatori ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA është njoftuar për skualifikimin e ofertës së tij ekonomike për arsyet si më poshtë:

*OE nuk ploteson Kapacitetin teknik ;*

*Pika 4 Analizat e paraqitura nuk plotesojn normat e kerkura ne shtojcen 5.*

II.4. Në datën 11.11.2022, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE “Publikimi i Njoftimit të fituesit” për procedurën e prokurimit.

II.5. Në datën 15.11.2022 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me nr. 2528/2022 protokolli, datë 15.11.2022 dhe me numër ankimi elektronik A/2022/2685 e operatorit ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij ekonomike të procedurës së mësipërme të prokurimit.

Në ankesë operatori ekonomik ankimues argumenton si më poshtë vijon:

*Më datë 27.10.2022 ora 10:00 është zhvilluar procedura e prokurimit me objekt “Blerje vaj”[...] ku shoqëria “ELBA-OIL 2015” SHA kemi marrë pjesë duke ofertuar në bazë të ligjit. Më datë 09.11.2022 ora 16:06 jemi njoftuar me vlerësimin e procedurës së mësipërme të prokurimit dhe me skualifikimin e ofertës sonë me arsyetimin si më poshtë:*

*OE nuk ploteson Kapacitetin teknik ;*

*Pika 4 Analizat e paraqitura nuk plotesojn normat e kerkura ne shtojcen 5.*

*Skualifikimi i mesiperm i ofertes tone eshte i padrejte dhe ne kundershjim me ligjin Nr. 162/2020 për Prokurimin Publik dhe V.K.M Nr. 285, datë 19.5.2021 për Miratimin e rregullave të prokurimit publik. Ne kemi paraqitur te gjitha analizat per produktet e kerkuara ne DST, si Vaj HV 46, Vaj 2T, Vaj 20Ë50, Vaj 80Ë90, Vaj 10Ë40, Vaj 15Ë40.*

*Normat e vendosura ne shtojcen 5 Formulari i Specifikimet Teknike jane shume te ngushta dhe nuk len vend per ofertimin e gjere te markave te ndryshme te vajit, gje qe bie ne kundershjim me me ligjin Nr. 162/2020 për Prokurimin Publik, Neni 36 Specifikimet teknike, Pika 2 ku thuhet:*

*2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.*

*Si dhe lë të kuptojme se keto norma jane vene posaçërisht per nje lloj marke Vaji e cila tregëtohet vetem nga nje kompani ne vendin tone, ne kete rast jemi ne kundërshtim te plote me komplet Nenin 2 Qëllimi, te ligjit te prokurimit publik , shprehet qartesisht se:*

*Qëllim i këtij ligji është:*

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;*
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;*
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;*
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;*
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;*
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.*

*Pra këto norma edhe në këtë rast bien në kundërshtim pikën 4 të nenit 36 nr. 162/2020 për prokurimin publik ku thuhet:*

*4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.*

*Sa më sipër ne jemi importues vajrash por gjithashtu kemi të drejtën të ofertojmë dhe me produkte nga ytregu i gjerë në vend duke respektuar kodet e vajrave të vendosura në DST dhe për këtë arsye kërkojmë kualifikimin e menjëhershëm të ofertës sonë si ofertë e sukseshme duke plotësuar të gjitha kriteret për kualifikim të vendosura nga AK në zbatim të kërkesave të kligjit nr. 162/2020 për prokurimin publik dhe VKM-së nr. 285 datë 19.05.2021 për miratimin e regullave të prokurimit publik.[...]*

II.6. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe formularin për publikim Nr.2528/2 prot., datë 15.11.2022 lidhur me arsyet e skualifikimit të operatorit ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA.

II.7. Nëpërmjet shkresës me nr. 2177/18prot., datë 18.11.2022, protokolluar me tonën me nr. 2528/3 prot., datë 22.11.2022 me objekt “*kthim përgjigje*”, është depozituar nga autoriteti kontraktor në Komisionin e Prokurimit Publik akti i trajtimit të ankesës së operatorit ekonomik ankimues, ku konstatohet, se autoriteti kontraktor ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA.

II.8. Nga shqyrtimi i akteve të ndodhura në fashikullin e shqyrtimit administrativ rezulton, se operatorët ekonomikë të interesuar në këtë procedurë prokurimi, nuk kanë dorëzuar argumente në përputhje me nenin 113 të LPP-së, në formë shkresore apo në sistemin e ankesave elektronike.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

#### Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA, se arsyeja e skualifikimit të ofertës së tij ekonomike “*OE nuk ploteson Kapacitetin teknik ; Pika 4 Analizat e paraqitura nuk plotesojnë normat e kerkura ne shtojcen 5*”, nuk qëndron, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në shtojcën “modifikim mbi dokumentet e tenderit” të procedurës së prokurimit objekt-ankimi të publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike nga autoriteti kontraktor, përcaktohet kriteri si më poshtë:

#### Bëhet:

*4. Operatorët Ekonomike të paraqesin Raport Analize të leshuar nga ISHTI ose institucione të tjera të akredituara sipas ligji, ku specifikimet teknike në Raport Analize të perputhen me specifikimet teknike të kerkuara nga AK. Raport analizat të jene të vitit 2021-2022.*

III.1.2. Në shtojcën 5, “*Formulari I Specifikimeve Teknike*”, të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

*Shtojca 5*

#### **FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE**

***Specifikimet Teknike të vajrave lubrifikante.***

***1. Vaj motorri 10Ë40:*** Të jetë vaj sintetik me specifikime teknike SAE API SL/CF, ACEA A3/B4, MB229.1, VË501.01/505.00

***2. Vaj Hidraulik 46:*** DIN 51524-2 Part II, Denison HF-0, HF-1, HF-2, Cincinnati Milacron P-68, P-69, P-70, Vickers HP Vane Pump Test M-2950 S, I-286 S.

***3. Vaj motorri SAE 15Ë40:*** API CF-4/CF/SH, ACEA E-2, MB 228.1, MIL-L-2104E, MAN 271.

***4. Vaj motorri SAE 20Ë50:*** API CF-4/CF/CE/CD/SG, ALLISON C3, VË505.00, MIL-L-2104D, CAT TO-2.

***5. SAE 80Ë90:*** API GL 4

***6. Vaji 2T:*** API TC (CEC TSC-3), ISO-L-EGC.

Raport Analizat duhet te plotesojne parametrat si me poshte, dhe te jene te leshuara gjate vitit 2021-2022.

### 1. Vaj motorri 10Ë-40

<b>Nr</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Metoda e testimit</b>	<b>Norma</b>
1	Densiteti ne 15 ° C (g/ml)	S SH EN ISO 3675	0.870-0.882
2	Viskoziteti ne100°C (mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	11 -13
3	Viskoziteti ne 40 °C(mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	95-100
4	Indeksi i viskozitetit ( V.I.)	ASTM D 2270	105-120
5	Temperatura e flakerimit COC (°C)	ASTM D 92 S SH EN ISO 2592	230-236
6	Temperatura e ngrirjes (° C)	S SH EN ISO 3016	-25 : -30
7	TBN (mg KOH/gr)	ISO 3771	6-9.2
8	Permbajtja e hirit (% m)	S SH EN ISO 6245	0.035-0.06
9	Permbajtja e ujit ne %	S SH ISO 3733	Nuk ka

### 2.Vaj Hidraulik 46 .

<b>Nr</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Metoda e testimit</b>	<b>Norma</b>
1	Densiteti ne 15 ° C (g/ml)	S SH EN ISO 3675	0.850-0.860
2	Viskoziteti ne100°C (mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	6.5 -7.8
3	Viskoziteti ne 40 °C(mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	45-47
4	Indeksi i viskozitetit ( V.I.)	ASTM D 2270	100-145
5	Temperatura e flakerimit COC (°C)	ASTM D 92 S SH EN ISO 2592	230-240
6	Temperatura e ngrirjes (° C)	S SH EN ISO 3016	-35 : -35
7	TBN (mg KOH/gr)	ISO 3771	3-8.5
8	Permbajtja e hirit (% m)	S SH EN ISO 6245	0.03-0.058
9	Permbajtja e ujit ne %	S SH ISO 3733	Nuk ka

### 3.Vaj motorri SAE 15Ë-40.

<b>Nr</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Metoda e testimit</b>	<b>Norma</b>
1	Densiteti ne 15 ° C (g/ml)	S SH EN ISO 3675	0.880- 0.8842
2	Viskoziteti ne100°C (mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	12.5 -15

3	Viskoziteti ne 40 °C(mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	108-145
4	Indeksi i viskozitetit ( V.I.)	ASTM D 2270	100-115
5	Temperatura e flakerimit COC (°C)	ASTM D 92 S SH EN ISO 2592	230-235
6	Temperatura e ngrirjes (° C)	S SH EN ISO 3016	-25 : -30
7	TBN (mg KOH/gr)	ISO 3771	7.6
8	Permbajtja e hirit (% m)	S SH EN ISO 6245	0.0524- 0.082
9	Permbajtja e ujit ne %	S SH ISO 3733	Nuk ka

#### **4.Vaj motorri SAE 20Ë50.**

<b>Nr</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Metoda e testimit</b>	<b>Norma</b>
1	Densiteti ne 15 ° C (g/ml)	S SH EN ISO 3675	0.880-0.895
2	Viskoziteti ne100°C (mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	15 -16
3	Viskoziteti ne 40 °C(mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	160-170
4	Indeksi i viskozitetit ( V.I.)	ASTM D 2270	90-95
5	Temperatura e flakerimit COC (°C)	ASTM D 92 S SH EN ISO 2592	240-255
6	Temperatura e ngrirjes (° C)	S SH EN ISO 3016	-25 :-30
7	TBN (mg KOH/gr)	ISO 3771	5-6
8	Permbajtja e hirit (% m)	S SH EN ISO 6245	0.085-089
9	Permbajtja e ujit ne %	S SH ISO 3733	Nuk ka

#### **5. Vaj SAE 80Ë90.**

<b>Nr</b>	<b>Treguesit</b>	<b>Metoda e testimit</b>	<b>Norma</b>
1	Densiteti ne 15 ° C (g/ml)	S SH EN ISO 3675	0.890-0.950
2	Viskoziteti ne100°C (mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	14.0-15.5
3	Viskoziteti ne 40 °C(mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	105-151
4	Indeksi i viskozitetit ( V.I.)	ASTM D 2270	90-150
5	Temperatura e flakerimit COC (°C)	ASTM D 92 S SH EN ISO 2592	235-240
6	Temperatura e ngrirjes (° C)	S SH EN ISO 3016	-25 : -30
7	TBN (mg KOH/gr)	ISO 3771	2.6-8.0
8	Permbajtja e hirit (% m)	S SH EN ISO 6245	0.0033- 0.007
9	Permbajtja e ujit ne %	S SH ISO 3733	Nuk ka

## 6. Vaji 2T.

<i>Nr</i>	<i>Treguesit</i>	<i>Metoda e testimit</i>	<i>Norma</i>
1	Densiteti ne 15 °C (g/ml)	S SH EN ISO 3675	0.880-0.890
2	Viskoziteti ne 100°C (mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	11.5 -14.0
3	Viskoziteti ne 40 °C (mm <sup>2</sup> /s)	S SH EN ISO 3104	120-125
4	Indeksi i viskozitetit ( V.I.)	ASTM D 2270	75-115
5	Temperatura e flakerimit COC (°C)	ASTM D 92 S SH EN ISO 2592	265-275
6	Temperatura e ngrirjes (°C)	S SH EN ISO 3016	-15 : -20
7	TBN (mg KOH/gr)	ISO 3771	3-4
8	Permbajtja e hirit (% m)	S SH EN ISO 6245	0.046- 0.0562
9	Permbajtja e ujit ne %	S SH ISO 3733	Nuk ka

### **-Mos plotesimi i kerkesave te mesiperme eshte kusht skualifikues.**

Përshkrimi i Specifikimeve Teknike të mallrave objekt i prokurimit, duhet të përshkruhen sa më saktë dhe plotësisht, për sa të jetë e mundur, duke krijuar kushte për konkurrencë të paanshme dhe të hapur midis të gjithë kandidatëve dhe ofertuesve. Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve plotësisht të justifikuara, duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të marrin parasysh kriteret e aksesit për personat me aftësi të kufizuara ose projektimin për të gjithë përdoruesit, siç kërkohet nga ligji në fuqi.

**SHËNIM:** Në Specifikimet Teknike, nuk duhet të përshkruhet asnjë markë specifike prodhimi ose burim ose proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një Operator specifik Ekonomik ose ndonjë markë tregtare, patentë, tip ose origjinë ose prodhim specifik, për të favorizuar ose eliminuar ndërmarrje ose produkte të caktuara. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste të jashtëzakonshme kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë ose e kuptueshme për të përshkruar objektin e Kontratës. Referencat e tilla duhet të shoqërohen me fjalët "ose ekuivalent".

Skicimet, parametrat teknik etj:

Specifikimi i Materialeve:

Përshkrimi i kerkesave të zbatimit të shërbimeve në lidhje me to:

Ndërsa në shtojcën 6, "Formulari i sasisë dhe grafikut të lëvrimit", të dokumenteve të tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet si më poshtë:

### **Sasia e mallit që kërkohet:**

<i>Nr</i>	<i>Emertimi</i>	<i>Njesi</i>	<i>Sasia</i>
1	Vaj HV 46	Liter	900
2	Vaj 2T	Liter	300



3	Vaj 20Ë50	Liter	160
4	Vaj 80Ë90	Liter	750
5	Vaj 10Ë40	Liter	160
6	Vaj 15Ë40	Liter	160

**Afatet e lëvrimet: 15 (pesëmbëdhjetë ) dite nga data e nënshkrimit të kontrates**

Artikulli	Përshkrimi	Shuma	Destinacioni	Periudha e dorëzimit

III.1.3. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike rezultojn se operatori ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA në përmbushje të kriterit sa më sipër ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë:

- Raport testimi vjara lubrifikantë S SH ISO 8681:1986 NR. 679/7prot datë 01.02.2022 KODI 377006 lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Raport testimi vjara lubrifikantë S SH ISO 8681:1986 NR. 679/2prot datë 01.02.2022 KODI 377007 lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Raport testimi vjara lubrifikantë S SH ISO 8681:1986 NR. 679/3prot datë 01.02.2022 KODI 377007 lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Raport testimi vjara lubrifikantë NR. 3540/2prot datë 13.07.2021 KODI 343512 lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Raport testimi vjara lubrifikantë NR. 3548/3prot datë 15.08.2019 KODI 343513 lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial.
- Raport testimi vjara lubrifikantë S SH ISO 8681:1986 NR. 679/3prot datë 01.02.2022 KODI 377003 lëshuar nga Inspektoriat Shtetëror Teknik dhe Industrial.

III.1.4. Neni 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, parashikohet shprehimisht se: *Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në:*

- a) *përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale;*
- b) *gjendjen ekonomike dhe financiare;*
- c) *aftësinë teknike dhe profesionale.*

*Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës.*

*2. Për sa i përket përshtatshmërisë për të kryer një veprimtari profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë që operatorët ekonomikë të regjistrohen në një nga regjistrat profesionalë ose tregtarë.*

III.1.5. Neni 40 pika 3 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

3. Kërkesat e veçanta të kualifikimit duhet të përfshijnë të gjitha kriteret specifike, në përputhje me nenin 77, të LPP-së. Kriteret duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Në çdo 38 rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.6. Neni 40 pika 5 dhe 6 “Kërkesa të veçanta për kontratat e mallrave”, të VKM Nr.285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet shprehimisht se:

5. Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon:

**c) mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit.**

6. Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike.

c) dëshmi për rezultatet e testeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë se operatorët ekonomikë duhej të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Në rastin konkret, bazuar në specifikimet teknike (shih shtojca 5 formulari i specifikimeve teknike) të mallrave objekt-prokurimi, Komisioni gjykon, se për autoritetin kontraktor është tepër rëndësishme që të prokurojë mallra që plotësojnë specifikimet teknike, duke përcaktuar në mënyrë të detajuar të gjitha specifikimet teknike për mallrat/produktet objekt-prokurimi si dhe duke përcaktuar në kriterin e veçantë të kualifikimit (citojmë) “[...]Operatorët Ekonomike të paraqesin raport analizë të lëshuar nga ISHTI ose institucione të tjera të akredituara sipas ligjit, ku specifikimet teknike në raport analizë të përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga AK. Raport analizat të jenë të

vitit 2021-202 [..]”. Referuar kriterit të veçantë të kualifikimit rezulton, se është kërkuar shprehimisht që operatorët ekonomikë ofertues, duhet të paraqesin raport analizë ku specifikimet teknike në këtë të fundit të përputhen me specifikimet teknike të autoritetit kontraktor për produktet e mëposhtme duke cituar produktet konkretisht: Vaj motorri 10W-40; Vaj hidraulik 46; Vaj motorri SAE 15W-40; Vaj motorri Sae 20W50; Vaj SAE80W90; Vaj 2T; Gjithashtu, në shtojcën e publikuar për specifikimet teknike janë parashikuar specifikimet teknike në lidhje me produktet e kërkuara. Nisur nga arsyeja e skualifikimit, pretendimeve të ankimuesit, si dhe nga shqyrtimi i dokumenteve e konkretisht raport analizave lëshuar nga ISHTI të dorëzuara nga operatori ekonomik ankimues, KPP konstatoi, se ky i fundit për produktet:

Vaj motorri 10W-40; ka paraqitur raport testimi që përmban specifikime teknike të cilat nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit të mallrave objekt i procedurës objekt-shqyrtimi konkretisht: Densiteti në 15, Viskoziteti në 100 viskoziteti në 40 indeksi i viskozitetit temperatura e flakërimit.

Vaj hidraulik 46; ka paraqitur raport testimi që përmban specifikime teknike të cilat nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit të mallrave objekt i procedurës objekt-shqyrtimi konkretisht: Densiteti në 15, Viskoziteti në 100 viskoziteti në 40 indeksi i viskozitetit temperatura e flakërimit.

Vaj motorri SAE 15W-40; ka paraqitur raport testimi që përmban specifikime teknike të cilat nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit të mallrave objekt i procedurës objekt-shqyrtimi konkretisht: viskoziteti në 40 temperatura e flakërimit, TBN KOH, përmbajtja e hirit.

Vaj motorri SAE20W50; ka paraqitur raport testimi që përmban specifikime teknike të cilat nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit të mallrave objekt i procedurës objekt-shqyrtimi konkretisht: Densiteti në 15, Viskoziteti në 100 viskoziteti në 40 indeksi i viskozitetit temperatura e flakërimit, TBN KOH, përmbajtja e hirit.

Vaj SAE80W90; ka paraqitur raport testimi datë 15.08.2019 që përmban specifikime teknike të cilat nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit të mallrave objekt i procedurës objekt-shqyrtimi konkretisht: Densiteti në 15, Viskoziteti në 100 indeksi i viskozitetit temperatura e flakërimit TBN KOH, përmbajtja e hirit.

Vaj 2T, ka paraqitur raport testimi që përmban specifikime teknike të cilat nuk përputhen me specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor ne dokumentet e tenderit të mallrave objekt i procedurës objekt-shqyrtimi konkretisht: Densiteti në 15 viskoziteti në 40 temperatura e flakërimit, temperatura e ngrirjes TBN KOH, përmbajtja e hirit.

Sa më sipër, referuar specifikimeve teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit për produktet e mësipërme, si dhe nga verifikimi i përmbushjes së këtyre specifikimeve në raport testimet e paraqitura nga operatori ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA, konstatohet, se ky i fundit nuk përmban të gjitha elementet/specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje, se operatori ekonomik ka detyrimin të paraqesë ofertën e tij në përputhje me të gjitha kriteret dhe specifikimet teknike të kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit. Komisioni sqaron, se nëse operatori ekonomik ankimues do të kishte pretendime në

lidhje me kriteret/specifikimet teknike të vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, ka pasur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës lidhur me kriteret e përcaktuara në dokumentet e tenderit, parashikuar nga neni 110 pika 1/1 e LPP. Në nenin 110 pika 1/1 të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet se “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të kontratës ose publikimi i ndryshimit të kërkesave në dokumentet e tenderit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.”. Komisioni gjykon, se është detyrë e operatorëve ekonomikë të përgatisin ofertat e tyre në përputhje me kriteret dhe kushtet e vendosura nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit, për sa kohë që i kanë pranuar ato dhe nuk i kanë bërë në asnjë rast objekt-ankimimi. Sa më sipër, KPP gjykon, se raport testimet e paraqitura nga operatori ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA, për produktet e mësipërme, nuk përmbushin të gjitha specifikimet e kërkuara nga autoriteti kontraktor në dokumentet e tenderit.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga operatori ekonomik ankimues “ELBA-OIL 2015” SHA, në procedurën e prokurimit objekt-ankimi, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se për sa kohë që pretendimi i mësipërm nuk qëndron dhe operatori ekonomik ankimues nuk përmbush kriteret e veçanta të kualifikimit dhe gjendja e tij faktike juridike pas arsyetimit të KPP mbetet e skualifikuar, shqyrtimi në themel i pretendimeve të tjera të palës ankimuese nuk ndryshojnë gjendjen juridike të këtij operatori, e për rrjedhojë nuk do të merren në shqyrtim në respekt të parimit të ekonomisë në shqyrtimin administrativ.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 261, datë 17.03.2010 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur e thjeshtuar” me Nr. REF-46041-10-14-2022, me objekt “Blerje Vaj” me fond limit 1 497 800 (një milion e katërqind e

nëntëdhjetë e shtatë mijë e tetëqind) lekë Pa Tvsh zhvilluar në datën 27.10.2022 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Parqeve dhe Rekreacionit.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
  3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “ELBA-OIL 2015” SHA.
  4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

#### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**